

VENDIM
Nr. 173, datë 26.10.2017

**MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “SMART TRADE & CONSULTING” SHPK NË
AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “d” të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, neneve 4, pika 1, germa “e”; 5, pika 1, germa “e”; 13 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 26.10.2017, mbasi shqyrtoi relacionin për licencimin e shoqërisë “Smart Trade & Consulting” sh.p.k. në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike, për gatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut,

konstatoi se:

Bordi i ERE-s me vendimin nr. 166, datë 12.10.2017, filloi procedurën për licencimin e shoqërisë “Smart Trade & Consulting” sh.p.k. në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.

Aplikimi i shoqërisë “Smart Trade & Consulting” sh.p.k. plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1, gjerat “a”, “b” “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, gjerat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”, “f”, “g”) është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, gjerat “a”, “b”, “c”, “d”) është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni teknik për aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4/10, gjerat “a”, “b” dhe “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Smart Trade & Consulting” sh.p.k në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti